



01-163



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 21 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPh-së Nr. 06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe Rregullores për procedurën e ndërtimit të ndërtesave, me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridik", miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës, 01 nr. 110-288305 dt. 31.12.2014, si dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 nr. 350/02-27081/20 dt. 03.02.2020, të parashtruar nga "Euro – Miti" shpk, me pronar Sait Grainca nga Ferizaji, për caktimin e kushteve ndërtimore për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa afariste me karakter të përkohshëm dhe me destinim-përmbajtje: Pikë e shitjes së derivateve të naftës dhe market, në Hajvali, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 12.06.2020, merr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I CAKTOHEN kerkuesit "Euro – Miti" shpk, me pronar Sait Grainca nga Ferizaji sipas kerkesës 05 nr. 350/02-27081/20 dt. 03.02.2020, kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa afariste me karakter të përkohshëm dhe me destinim - përbajtje: Pikë e shitjes së derivateve të naftës, "Fast Food" & market, me etazhitet P+0, në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1374-0 ZK Hajvali.

Hajvali.
II. Lokacioni, për të cilën caktohen këto kushte ndërtimore, gjendet në parcelën kadastrale nr. 1374-0 ZK Hajvali, e cila shtrihet në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Prishtinës, e destinuar “rrjet ekologjik”. Kushtet ndërtimore për ndërtimin e ndërtesave të lartcekura caktohen bazuar në “Rregulloren për procedurën e ndërtimit të ndërtesave, me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridik”, miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës, 01 nr. 110-288305 dt. 31.12.2014.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelës kadastrale nr. 1374-02 KX Hajvan, eshte:

IV. Kushtet ndërtimore për rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar, bazuar në kriteret e rregullores dhe parametrat urban për realizimin - ndërtimin e kompleksit me ndërtesa afariste me karakter të përkohshëm dhe me destinim - përbajtje: Pikë e shitjes së derivateve të naftës, "Fast Food" & market, auto larje dhe hapësira tjera përcjellëse, janë:

- Gabariti, pozita, organizimi, etazhiteti i ndërtesave, kyçja e kompleksit në komunikacion, raporti i ndërtesave me vijën rregulluese dhe ndërtimore, rrugët e planifikuara të kompleksit si dhe kushtet tjera, të jenë në terti sipas prezantimit grafik të përshkruar në planin e lokacionit –“zgjidhja urbane”, bashkangjitur këtij Vendimi;
 - Qasja, hyrja - dalja në kompleks, të bëhet nga magjistralja Prishtinë-Gjilan, duke respektuar Ligji Nr. 2003/11 Ligji Për Rrugët, ndryshimet e këtij Ligji dhe aktet nënligjore që dalin nga ky lig;
 - Shfrytëzimi maksimal për ndërtim i parcelës kadastrale, në sipërfaqe prej $5545m^2$, mund të jetë max.40%, gjegjësisht $5545 \times 0.4 = 2218m^2$ (sipas projekt propozimit është $S=1036m^2$);
 - Sipërfaqja e ndërtesave të planifikuara, sipas projekt propozimit janë: "marketi" me zyra dhe nyje sanitare, është me sipërfaqe prej $S=529.45m^2$, Streha - Pikë e shitjes së derivateve të naftës, është me sipërfaqe totale $S=437m^2$, dhe terasa me sipërfaqe $S=174m^2$. Në bazë të projektit konceptual të

- prezantuar, streha, terasa dhe ndërtesa kanë ndërhyrje arkitektonike në mes vete, atëherë gabariti total i ndërtesës, terasës dhe strehës është me sipërfaqe $1036m^2 < 2218m^2$;
- Etazhiteti i ndërtesave me përbajtje: market, restaurant, zyrat e personelit dhe nyjet sanitare, të jetë P+0, me lartësi maksimale 5.0m' (sipas projekt propozimit);
 - Etazhiteti i ndërtesës të strehës-pikë e shitjes së derivateve të naftës, të jetë gjithashtu P+0 dhe me lartësi maksimale H=6.7m', gjegjësisht me lartësi të mjaftueshme për qasjen e makinerisë për furnizim me karburante (sipas projekt propozimit);
 - Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesave të përkohshme, në kuadër të kompleksit, të jetë për afarizëm, përkatësisht Pikë e shitjes së derivateve të naftës, restaurant, market për dhe furnizime të konsumatorëve;
 - Kuota e nivelit të përdheses së ndërtesës nga niveli i terrenit – platos ose trotuarit, mund të jetë max. 30 cm';
 - Ndërtesa me karakter të përkohshëm lejohen të ndërtohen nga materialet montuese dhe lehtë demontuese, si: hekuri, druri, plastika apo edhe ndonjë material i ngashëm, dhe nuk lejohen elementet muratore dhe nga betoni për ndërtimin e ndërtesave (projekt propozimi është nga konstruksioni i hekurit);
 - Bazamenti i ndërtesave – themelet, mund të jenë nga betoni i armuar;
 - Në ndërtesa nuk lejohet ndërtimi i etazheve nëntokësore;
 - Distanca e ndërtesave nga kufiri i parcelës fqinje mund të jetë deri në 120 cm', me pëlqim të pronarëve të parcelave fqinje, kurse nëse në parcelat fqinje ndodhen ndërtesat ekonomike, distanca mund të eliminohet me pëlqimin e pronarëve, ndërsa sipas Planit distanca minimale nga kufiri i parcelës është 0.5 H, ku H është lartësia e ndërtesave. Ndërtesa mund të vendoset edhe në kufi të parcelës kadastrale fqinje në rast se investitor i prezanton pëlqimin nga pronari i parcelës.
 - Sipërfaqja e gjelbëruar e parcelave, e përcaktuar në bazë të indeksit të Sipërfaqes së Gjelbëruar, duhet të jetë së paku 40%, përashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, kjo sipërfaqe mund të jetë së paku 30%.
 - Në kuadër të kompleksit të planifikohen edhe rrugë qarkulluese, për qasje të zjarrfikësve si dhe shtigje, sipërfaqe të pllakëzuara dhe vend-parkime të mjaftueshme për personel dhe klientë;
 - Në kuadër të kompleksit të parashihet edhe vendosja e rezervuarëve metalik të izoluar për deponimin e derivateve të naftës (3 copë), të cilët planifikohen të vendosen në vend të përshtatshëm, nën tokë – në dhe, ku në hapësirën e vendosjes nuk lejohet të ketë elemente nga betoni;
 - Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
 - Gjatë punimeve ndërtimore duhet kujdes i veçantë në mbrojtjen e dobive natyrore.

V. Kushtet e veçanta – për aplikim për leje ndërtimore, duhet të sigurohen:

- *Pëlqimin Mjedisor - Vlerësimi i N dikimit në Mjedis, i lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;*
- *Pëlqimin në lokacion, mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjarri për ndërtimin e ndërtesave me karakter të përkohshëm me destinim: Pikë e shitjes së derivateve të naftës dhe market, lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme - Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave;*
- *Licencën e kompanisë për zhvillimin e biznesit për pikat për furnizimin e automjeteve me derivate;*
- *Pasi që parcela kadastrale nr. 1374-0 ZK Hajvali, tangentojnë magjistralen Prishtinë – Gjilan, duhet të prezantohet aprovimi i zgjidhjes urbane si dhe aprovimi për çasje në magjistrale të lëshuar nga Ministria e Infrasukturës duke dëshmuar që kjo Ministri nuk ka planifikuar ndonjë zgjerim eventual të magjistrales.*
- *Pasi që parcela kadastrale në pjesën perëndimore kufizohet me pellgun ujor (hendekun), para aplikimit për leje ndërtimi, duhet të prezantohet pëlqimi nga organi kompetent me anë të cilës miratojnë raportin e distancës së ndërtesës së planifikuar (pikës së furnizimit me derivate) me kufirin e pellgut ujor.*

Para aplikimit për leje ndërtimi, duhet të sigurohet dokumentacioni i përshkruar në pikën V të këtyre kushteve ndërtimore, në të kundërtën nuk mund t'i nënshtroheni procedurën për aplikim për leje ndërtimi.

VI. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcella kadastrale nr. 1374-0 ZK Hajvali, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, është me klasë të kualitetit "Arë e klasit 4", dhe pasiqë, për Planin Zhvillimor Komunal nuk është marrë pëlqim nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë

dhe Zhvillimit Rural, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, për iniciativën e procedurës, kërkohet paraprakisht ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, për parcelën e paraparë për ndërtim, konform dispozitave ligjore të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që rregullojnë këtë fushë. Për paisje me këtë pëlqim, me kërkesë duhet t'i drejtoheni kësaj drejtorie, me dokumentacionin e nevojshëm, e cila përmes aktit përcjellës, do të procedohet, në kompetencë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Dokumentacioni i nevojshëm duhet të përbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore, i lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuesit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit);

VII. Deklarata e noterizuar nga pronari/investitori, duhet të prezantohet me dokumentacionin ndërtimor për aplikim për leje ndërtimore, se ndërtesa është me karakter të përkohshëm, se nuk do të jetë pengesë për realizimin- zbatimin e planit urban për atë zonë, dhe se investitori / qiramarrësi, ndërtuesi do ta largojë në afat prej 8 ditëve.

VIII. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlgjimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përbajtje si në vijim:

- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ajroincizimi - ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese ;
- Përshkrimin teknik të ndërtuesës (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlgjimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohtorja e Qytetit.

IX. Hartimi i dokumentacionit ndërtimor-projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV. dhe V., projekt propozimin e prezantuar, normat dhe standardec në fuqi për këto lloje të ndërtuesave, dhe të jenë në harmoni me rregullativët ligjore në fuqi:

- a). Udhëzimin Administrativ Nr. 2007/18 për kërkesat teknike për ndërtimin dhe funksionimin e pikave përfurnizimin e automjeteve me karburante;
- b). Udhëzimin Administrativ Nr. 09/2010 për përbushjen e kushteve teknike për subjektet që merren me importin, deponimin, shitjen me shumicë dhe pakicë të karburanteve;
- c). Udhëzimin Administrativ Nr. 23/2012 – MPB për normat teknike përfurnizimin e mjeteve motorike me derivate të naftës, deponimin dhe toçitjen e derivateve të naftës në pikat e shitjes me pakicë;
- d). Rregulloren Nr. 25/2012 për normat teknike të mbrojtjes nga zjarri në ndërtimin e impianteve përlengjet e ndezshme, deponimin dhe toçitjen e tyre;
- e). Udhëzimin Administrativ Nr. 33/2007 për kushtet teknike të ndërtuesave, ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuarë.

dhe duhet të përbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - Planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m', me ndërtuesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - Planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimisione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë, relative dhe absolute;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimisione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë me pozicionim të ndërtuesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrëthinë, si dhe me pozicionim të ndërtuesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;

- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshitë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhesë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe paralogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore-zejtare;
- Detajet e nevojshme, në përpjesë 1:5; 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë, me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit-llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionimin dhe detaje e nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro–energetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01nr.035-174324 dt.12.07.2016, e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik, në bazë të analizave të terrenit;

X. Vlefshmëria e kushteve ndërtimore është një (1) vit, duke llogaritur nga dita e lëshimit, kurse procedura e ndryshimit dhe plotësimi të tyre të bëhet me kërkesë të pronarëve ose investitorit, në procedurën e njëjtë e të paraparë për lëshimin e tyre.

A r s y e t i m

Kërkuesi "Euro – Miti" shpk, me pronar Sait Grainca nga Ferizaji sipas kërkesës 05 nr. 350/02-27081/20 dt. 03.02.2020, me kërkesën 05 nr. 350/02-27081/20 dt. 03.02.2020, të drejtar në Drejtorinë e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, kanë kërkuar caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për lejimin e ndërtimit të ndërtesës – pikë e furnizimit me derivate, në lokacionin e përshkruar në dispozitiv të këtij Vendimi.

Bashkangjitur me kërkesë është prezantuar dokumentacioni si në vijim:

- Kopjet e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale nr.1374-0 ZK Hajvali;
- Incizimin gjeodezik të parcelës kadastrale, të punuar nga gjeodeti i licencuar Faton Bajselmani, me numër të licencës 125, dhe datë të skadimit 21.08.2023;
- Projektin konceptual – zgjidhja urbane e punuar nga kompania projektuese "Coorepartion Architecture" sh.p.k, me certifikatë të regjistrimit të biznesit me nr. 810824096, me bartës të projektit Flamur Grajçevci, MSc. Ark.;
- Fotokopjen e pa vërtetuar e cerifikatës së biznesit të kompanisë "Euro – Miti" shpk, me numër të biznesit 810652554;
- Vërtetimin e tatimit në emër të "Euro – Miti" shpk, me numër 25426/20 dt. 31.01.2020;
- Fotografi të gjendjes ekzistuese të lokacionit;
- Fotokopjet e letërnjoftimit të Faik Grainca;

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, bazuar në pikën 1.2.2. të Neni 13, të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Nr.06/2017 dt. 23.05.2017, për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimini për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve, me datën 19.02.2020, ka vendosur njoftimin publik i cili ka qëndruar 15 (pesëmbëdhjetë) ditë në lokacion – deri më datën 05.03.2020. Gjatë kësaj periudhe kohore, Bashkësia Lokale Hajvali, me shkresën zyrtare "Ankesë" 05-070/01-43407/20 dt. 24.02.2020, i janë drejtar Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, lidhur me ndërtimin e pompës së benzinës në magjistralen Prishtinë-Gjilan ana e djathtë.

Konform pikës 2. të nenit 13, të UA 06/2017 të MMPH-së, ankesa e kompletuar 05 nr. 070/01-43407/20 dt. 24.02.2020, e parashtruar nga Bashkësia Lokale Hajvali, është vendosur në web faqen e Komunës së Prishtinës me datën 20.05.2020, dhe njëjtë ka qëndruar 5 (pesë) ditë.

Kjo Drejtori, pas shqyrtimit të ankesës së lartçekur, me shkresën zyrtare "Informim" 05 nr. 070/01-43407/20 dt. 27.05.2020, ka informuar Bashkësinë Lokale Hajvali, si në vijim, citoj:

"Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës Ju informon se, kërkesa e parashtruar 05 nr. 350/02-27081/20 dt. 03.02.2020, nga pronari/investitor "Euro-Miti" sh.p.k., me certifikatë të regjistrimit të biznesit 810652554, me pronar Sait Grainca, për caktimin e kushteve ndërtimore për lejimin e ndërtimit të ndërtesës me karakter të përkohshëm - pikë e furnizimit me derivate, është kërkesë e bazuar në "Rregullore për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridik", 01. nr. 110-288305, më 31.12.2014 të miratuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës.

Në rast të miratimit të ndonjë projekti eventual nga Ministria e Infrastrukturës apo fillimit të realizimit të zgjerimit të magjistraleve Prishtinë-Gjilan në lokacionin ku gjendet parcela në fjalë, konform neneve dhe pikave të lartcekura të "Rregullore për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridik", 01. nr. 110-288305, më 31.12.2014 të miratuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, do të shfuqizoj lejen ndërtimore dhe ndërtimi do të largohet nga parcela në fjalë."

Shkresa zyrtare e lartcekur (përgjigja e drejtuar Bashkësisë Lokale Hajvali) "Informim" 05 nr. 070/01-43407/20 dt. 27.05.2020, konform pikës 2. të nenit 13, të UA 06/2017 të MMPH-së, e njëjtë është publikuar edhe në web faqen e Komunës së Prishtinës me datën 08.06.2020

Drejtoria e Urbanizmit pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për zonën në fjalë, rregullativën ligjore në fuqi, në procedurë, ka kerkuar mendimi profesional nga zyrtari përgjegjës për komunikacion i kësaj Drejtorie, dhe i njëjti me shkresën zyrtare të datës 03.06.2020, konstaton si në vijim, citoj: "Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Euro Mitit shpk., në Hajvali, Prishtinë, lidhur me kërkesën e kushteve ndërtimore të lëndës 05-350/02-27081/20 dt. 03.02.2020, kyçja për automjete në rrugën nationale N25.2 drejtimi Prishtinë - Gjilan, duhet të sigurohet me pëlqimin e dhënë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit, dhe gjithashtu edhe zgjidhja e kyçjes hyrje - dalja nga hapësira e kësaj zgjidhje në rrugën nationale duhet të bëhet në harmoni me kriteret dhe udhëzimet që i jep Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit. Ndërsa zgjidhja e brendshme në hapësirën e pompës së derivateve lidhur me parkingjet e parapara në kuadër të hapësirës së pompës së derivateve mund të pranohet si e tillë. Dimensionimi i vendparkimeve duhet të jenë në harmoni me Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, dhe të aplikohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjeve, hyrje - dalje nga pompa e derivateve."

Drejtoria e Urbanizmit, bazuar në konstatimet e më sipërme, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 7 dhe 8 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017, për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënim i përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridik", miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës, 01 nr. 110-288305 dt. 31.12.2014, dhe se plani i situacionit - "zgjidha urbane", i propozuar me projekt propozimin e ndërtesave, si dhe kjo drejtori me dt. 19.02.2020, ka vendos njoftimin publik, për lënien në dispozicion të publikut deri me datën 05.03.2020, dhe nuk është prezantuar ndonjë vërejtje apo sygjerim, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i situacionit -"zgjidha urbane" e kompleksit me ndërtesa të planifikuara të pikës së furnizimit me derivate.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.


I dërgohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në dosje të lëndës, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 350/02-27081/20 DT. 12.06.2020


Zyrtari,
Zejnulla Rexhepi



Faqe 5 prej 5



A circular blue ink stamp. The outer ring contains the text "REPUBLIKA E KOSOVO" at the top and "MINISTRIA E PRISHTIT" at the bottom. The inner circle contains the text "ESTORIA E URBANIT".



Nr. i parcelës: 1328-1

Sip. Parcel. =2590.00 m²

Siperfaçet e projektuara

Sip. projektuar: Objekti 425.00m² (16.4%)
Strha 437.00m² (16.8%)
Terasa 174.00m² (6.80%)

Totali 1036.00m² (40.0%)

Siperfaçet e qilbrimit

Sin-gleichbrümit: 590 28m² (22 7%)

Etazhitei max. R+0

Nr i parkingjeve. 14

Porositesi:
"Euro-Miti" Sh.P.K.

Cooperation Architecture
Studio alternativo e Arkitettura dha Dizajnit Urban
Studio 1877 11 120 784 Email: cooperarchitcura@gmail.com

Ark. Flamer Grajčevci

Ark. Kushtrim Musa

limit:

Situación

P=1:200 ISO_A3
Nr. i flates